

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR “GEGA-BR 2019” SH.P.K.

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë; “GEGA –BR 2019” shpk

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 01/08/2019, une, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “GEGA-BR 2019” SH.P.K.

(2) Themeluesi i shoqërisë është:

1. z. **DRITAN GEGA**, lindur ne Berat me 16.04.1968 dhe banues ne lagja “30 vjetori” Berat, shtetas shqiptar, mbajtes i Leternjoftimit Id numer 032064835, person madhor me zotësi juridike për të vepruar; qe vendos si më poshtë:

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin me objektin e mëposhtëm:

- 1. Transport rrugor kombetar dhe nderkombetar mallrash per vete, per te tretet dhe me qera.*
- 2. Prodhimi i konfeksioneve per vete dhe per te tretet me materialin e vet apo te treteve, i prodhimit te materialeve te ndryshem tekstile dhe industriale (te te gjitha llojeve), tregtimi i tyre me shumice e pakice. Import- eksport i makinerive dhe aksesoreve per prodhimin e tyre.*
- 3. Shitblerja e pasurive te paluajtshme.*
- 4. Ndertimi dhe rikonstruktimi i te gjitha llojeve te objekteve. Punime ndertimi te kategorise 1,2,3,6,9 ne fushen e ndertimit*
- 5. Tregtim me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industrial e te ndertimit etj. kerkim, zbulim dhe shfrytezim mineralesh, mermeri e graniti, perdorimi i lendeve plasese per perdorim civil, transporti dhe magazinimi i tyre si dhe import eksporti i tyre,*
- 6. Import eksport te te gjitha artikujve, industrial, bujqesore dhe ushqimore, hoteleri, tregtim te ushqimit social (bar-restorant) etj.*
- 7. Import, eksport e tregtim i mjeteve motorike, autovetura, kamione, mjete bujqesore e industriale, si traktore, eskavator, fadroma, mjete me zinxhire, e pjese kembimi te tyre*
- 8. Tregti me pakice te karburanteve, vajrave lubrifikante dhe gazi te lengshem GNL Servis per mjete dhe makineri + lavazho*

Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve mund të përcaktohet një afat kohezgjatjeje i cili mund të ndryshohet një ose më shumë herë, sërish me një vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4:

Selia dhe Adresa Elektronike

(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Berat, pasuria numer19/246, zona kadastrale numer 8501 me adrese lagja "Barikada" Berat, rruga Antipatrea, ish Kombinati i Textileve , Berat**

(2) Adresa elektronike është: **gega-br 2019@yahoo.com**

Shoqëria mund të ushtrojë veprimtarinë e saj ekonomike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Për këtë arsye, mund të ketë zyra të tjera operationale, degë dhe agjensi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë vendit, në përputhje me legjislacionin e shteteve në të cilat do të hapen.

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Dritan Gega: Zoterues i 1(nje) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 lekë që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i regjistruar mund të rritet pa kufij në çfardo momenti, një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Në rast rritjeje të kapitalit të regjistruar, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me kuotat e kapitalit të zotëruar.

Në rast se ata nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesëmarrjen respektive dhe në rast mungese të nënshkrimit, mund të nënshkruen nga të tretët me miratim të ortakëve.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit



Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike; 3
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e

mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10 **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të audituesve të pavarur;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12 **Përfshirja nga e drejta e votës**

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13 **Administrimi**



- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 4 vjet, me të drejtë rizgjedhje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- (2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3) Administratori i shoqërisë është z. **DRITAN GEGA**, lindur ne Berat me 16.04.1968 dhe banues ne lagja "30 vjetori" Berat, shtetas shqiptar, mbajtes i Leternjoftimit Id numer 032064835, person madhor me zotësi juridike për të vepruar;

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të therasin Asamblesë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit



Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Padiësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV
Viti financiar-ekspertet



Neni 16 **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17 **Audituesit e pavarur**

Audituesi i pavarur ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqërisë, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Kreu V **Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

Neni 18 **Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqëri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19 **Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20 **Baza Ligjore**



Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

**ORTAKU I VETEM
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"GEGA-BR 2019"**

z. Dritan Gega

Dritan Gega
Du



**AKT THEMELIM
I
SHOQËRISË TREGTARE
"GEGA-BR 2019" SH.P.K**

Në përputhje me ligjin 9901 datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar sot me date 23/07/2019 në cilësinë e Ortakut themelues:

z. DRITAN GEGA, lindur ne Berat me 16.04.1968 dhe banues ne lagja "30 vjetori" Berat, shtetas shqiptar, mbajtes i Leternjoftimit Id numer 032064835, person madhor me zotësi juridike për të vepruar,, vendos si më poshtë:

Neni 1 – FORMA LIGJORE

Te themeloje shoqërine me përgjegjësi të kufizuar me emrin "GEGA-BR 2019" Sh.p.k. me ortak te vetem z.DRITAN GEGA

Neni 2 - SELIA

Shoqeria tregtare "GEGA-BR 2019" Sh.p.k. ka selinë e saj në Berat, pasuria numer19/246, zona kadastrale numer 8501 me adrese lagja "Barikada" Berat, rruga Antipatrea, ish Kombinati i Textileve , Berat

Neni 3 - KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 4 – OBJEKTI I AKTIVITETIT

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë tregtare "GEGA-BR 2019" Sh.p.k. ajo është:

- 1. Transport rrugor kombetar dhe nderkombetar mallrash per vete, per te tretet dhe me qera.*
- 2. Prodhimi i konfeksioneve per vete dhe per te tretet me materialin e vet apo te treteve, i prodhimit te materialeve te ndryshem tekstile dhe industriale (te te gjitha llojeve), tregtimi i tyre me shumice e pakice. Import- eksport i makinerive dhe aksesoreve per prodhimin e tyre.*
- 3. Shitblerja e pasurive te paluajtshme.*
- 4. Ndertimi dhe rikonstruktimi i te gjitha llojeve te objekteve. Punime ndertimi te kategorise 1,2,3,6,9 ne fushen e ndertimit*
- 5. Tregtim me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industrial e te ndertimit etj. kerkim, zbulim dhe shfrytezim mineralesh, mermeri e graniti, perdorimi i lendeve plasese per perdorim civil, transporti dhe magazinimi i tyre si dhe import eksporti i tyre,*
- 6. Import eksport te te gjithe artikujve, industrial, bujqesore dhe ushqimore, hoteleri, tregtim te ushqimit social (bar-restorant) etj.*
- 7. Import, eksport e tregtim i mjeteve motorike, autovetura, kamione, mjete bujqesore e industriale, si traktore, eskavator, fadroma, mjete me zinxhire, e pjese kembimi te tyre*
- 8. Tregti me pakice te karburanteve, vajrave lubrifikante dhe gazi te lengshem GNL Servis per mjete dhe makineri + lavazho*

Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 5 - KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themelor i shoqërisë tregtare "GEGA-BR 2019" Sh.p.k. është 100,000 lekë (njëqind mijë) lekë, i paguar tërësisht nga ortakët i vetëm të shoqërisë në masën 100%.

Neni 6

Shoqëria administrohet nga një ose disa administratorë persona fizike, qofshin këta edhe jo ortakët të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratorët qëndrojnë në postin e tyre për katër vjet financiarë, me mundësinë për tu rizgjedhur.

Administratori i shoqërisë është **z. DRITAN GEGA**, lindur në Berat më 16.04.1968 dhe banues në lagja "30 vjetori" Berat, shtetas shqiptar, mbajtes i Leternjoftimit Id numer 032064835, person madhor me zotësi juridike për të vepruar;

Neni 7

Shoqëria ka vulën e saj zyrtare me përmbajtjen e mëposhtme:
Shoqëria Tregtare "GEGA-BR 2019" Sh.p.k.

Neni 8 – VITI FINANCIAR

Viti fiskal i shoqërisë mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti.

Në fund të çdo viti financiar, administratorët e kompanisë kryejnë inventarin dhe llogaritë vjetore, në përputhje me dispozitat ligjore për kontabilitetin dhe përgatisin një raport me shkrim për administratën. Raporti i administratës, inventarët dhe llogaritë vjetore të hartuara nga administratori paraqiten në miratimin e anëtarëve brenda një periudhe 6 mujore duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 9

Në rast se Shoqëria mbetet me një ortak të vetëm, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Ortakëve ushtrohen nga ortakët i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga Ortakët i Vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen apo të fshihen. Ortakët i vetëm mund të delegojnë kompetencat e tij.

Neni 10 - SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

Prishja e shoqërisë tregtare "GEGA-BR 2019" Sh.p.k. mund të kryhet në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye, duke vepruar në përputhje me kriteret e përcaktuara në Statutin e Shoqërisë dhe ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 11 - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Ky akt themelues përpilohet në pesë kopje të barazvlerëshme dhe nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues të shoqërisë tregtare "GEGA-BR 2019" sh.p.k.

ORTAKU I VETËM THEMELUES I SHOQËRISË TREGËTARE
"GEGA-BR 2019" sh.p.k

Dritan Gega

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA VENDORE E NOTERISE VLORE
NOTERE ANDROMAQI BERATI
Nr.*176*... rep



TAKSA E PULLES
II KAPITULLI
NE KODIN E APSTIVUAR

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot ne Berat me 01 gusht 2019 perpara meje notere Andromaqi Berati, me zyre ne lagjen "30 Korriku" (perballe Gjykses se Rrethit) u paraqit personalisht deklaruesi :



DRITAN GEGA, lindur ne Berat me 16.04.1968 dhe banues ne lagja "30 vjetori" Berat, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i njohur personalisht prej meje noteres, mbajtes i Leternjofimit Id numer 032064835

I cili , me cilesine e ortakut te vetem themelues te shoqerise tregtare "GEGA-BR 2019" shpk, nen pergjegjesine e tij personale dhe me vullnetin e tij te lire nenshkroi ne prezencen time noteres dokumentiat bashkangjitur : **AKT THEMELIMI DHE STATUT I SHOQERISE TREGTARE "GEGA-BR 2019" SH.P.K, date 01.08.2019.**

Une noterja vertetoj nenshkrimin e tij.

NOTERE



REPUBLICA E SHQIPERISE REPUBLICA OF ALBANIA

mbemri/surname
Gega

emri/given name
Dritan

thetesia/nationality
Shqiptare/Albanian

vendndaja/place of birth
Berat, Berat

data e lindjes/date of birth
16-04-1968

data e lëshimit/date of issue
31-01-2013

autoriteti i lëshues/authority
MB

nr. i kartës/identification card no.
032064B35

gjinia/sex
M

data e skadimit/date of expiry
30-01-2023

nr. personi/personal no.
G80416030M